

## **Programi “Forcimi i Kapaciteteve të Sektorit Jo-fitimprurës”**

Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti është një organizatë shqiptare, anëtare e Rrjetit Ndërkombëtar të Partnerëve për Ndryshim Demokratik<sup>1</sup> me qendër në Bruksel.

Prej afro 9 vjetësh Partnerët Shqipëri punon në fushën e ndërtimit të kapaciteteve në nivel individual dhe organizativ në sektorin jo-fitimprurës, administratë qendrore e vendore dhe sektorin e biznesit.

Në këtë dekadë të fundit sektori jo-fitimprurës ka pësuar rritje në numër, zgjerim në mbulimin gjeografik dhe diversifikim në shërbime. Pavarësisht këtyre arritjeve, forcimi i organizatave jo-fitimprurëse në nivel institucional si dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore mbetet një nevojë. Kjo për shkak të rrjedhjes së trurit që ka efektuar thellë sektorin, por edhe sfidave të rritjes dhe nevojës për të qenë pjesë aktive e proceseve integruese në vend.

Ngritja dhe diversifikimi i fondeve, gjenerimi i fondeve nëpërmjet shërbimeve mbetet një nga pikat më të dobëta të sektorit, kjo në kushtet e tërheqjes së një numri të konsiderueshëm donatorësh apo reduktimit të ndihmës së huaj për sektorin.

Kushtet dhe kriteret e financimeve janë bërë gjithnjë e më konkurruese duke e vënë sektorin përpara sfidave të shumta lidhur me kriteret e menaxhimit të burimeve njerëzore e financiare, raportimit dhe transparencës.

Me avancimin e kuadrit ligjor fiskal, marrëdhënia e sektorit me institucionet respektive shtetërore është intensifikuar dhe ndërlikuar. Kjo ka ardhur si pasojë e kërkesave ndonjëherë të paqarta të shtetit nga njëra anë dhe nga ana tjetër e mangësive në njohjen e legjislacionit dhe mungesës në kapacitete njerëzore të specializuara nga ana e sektorit.

Në këto kushte Partnerët Shqipëri synon të asistojë sektorin në plotësimin e këtyre nevojave dhe adresimin e sfidave të rritjes. Si një institucion i specializuar në fushën e trainimit dhe me eksperiencë e ekspozim të gjerë në programet e asistencës për sektorin, Partnerët Shqipëri synon që nëpërmjet këtij programi të adresojë ato nevoja të cilat gjykohen si të rëndësishme nga organizatat e interesuara.

### **Kush është përmbajtja?**

Përmbajtja e programit do të bazohet në nevojat aktuale të identifikuara nga sektori i OJF-ve nëpërmjet administrimit të një pyetëso. Ju lutemi gjeni bashkangjitur ***Pyetësoin e Vlerësimit të Nevojave të Sektorit Jo-Fitimprurës.***

Partnerët Shqipëri ju lutet ta plotësoni dhe ta dërgoni atë brenda datës **20 nëntor** në adresën e email-it: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org) ose në zyrat e Partnerëve Shqipëri në adresën: Rruga Muhamet Gjollësja, Pallati 16/1, Shkalla 1, Ap.9, hyrja mbi dyqanin e bojrave Vivechrom, përballë Hotel Diplomatit të vjetër.

---

<sup>1</sup> Rrjeti Ndërkombëtar i Partnerëve për Ndryshim Demokratik përbëhet nga 20 Qendra të cilat ofrojnë trajnime për zgjidhje konflikti si dhe shërbime për shoqërinë, OJF-të, qeverinë qendrore dhe vendore, dhe sektorin privat në vendet e tyre dhe në vende të tjera në botë.

## **Si do të ofrohet programi?**

Programi do të konsistojë në trainime për grupe mikse dhe /ose asistencë për organizata individuale sipas nevojës.

## **Sa i gjatë është programi?**

Ky program do të jetë i hapur gjatë gjithë vitit 2010. Trainimet dhe asistencat e para individuale planifikohen të jepen duke filluar që nga muaji Janar 2010.

## **Kush do të ofrojë programin?**

Programi do të ofrohet nga stafi i Partnerëve Shqipëri me një përvojë të konsoliduar disa vjeçare në ofrimin e shërbimeve të ndryshme për sektorin jo-fitimprurës në Shqipëri e jashtë saj. Stafi i Partnerëve Shqipëri prej disa vitesh ofron trainime, konsulenca, asistencë në hartimin e planeve strategjike, lehtësime procesesh për sektorin e aktorë të tjerë. Partnerët Shqipëri siguron cilësi, mbështetje të vazhdueshme e konfidencialitet për të gjithë përfituesit.

Për çështje specifike Partnerët Shqipëri do të ftojë herë pas here dhe ekspertë të vendit e të huaj.

## **Si mund të aplikoj?**

**Programi i trainimit:** Partnerët Shqipëri brenda muajit **Dhjetor 2009** do të publikojë një kalendar trainimesh me çështjet që do të trajtohen në baza mujore. Trainimet do të jenë një deri në dy ditore. Bashkangjitur tij do të jetë edhe forma e aplikimit për pjesëmarrje në trainime.

**Asistenca individuale:** Organizatat e interesuara për të përfituar nga asistenca individuale mund të kontaktojnë Partnerët Shqipëri, duke shprehur fushën e asistencës për të cilën kanë nevojë, nëpërmjet adresës së e-mailit: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org), në numrat e telefonit: 04 2254 881/3, ose në zyrat e Partnerëve Shqipëri në adresën e përmendur më lart.

## **Sa kushton?**

**Programi i trainimit:** Kosto e pjesëmarrjes për person është 5,000 Lekë në ditë.

Në kosto përfshihet:

- Moduli i trainimit
- Dosje e trainimit (bllok, stilolaps, etj)
- Kafe, ujë
- Kosto e sallës
- Çertifikatë për pjesëmarrësit

Në rastet kur do të ketë më shumë se dy (2) persona nga një organizatë, do të aplikohet një zbritje prej 20% e koston së pjesëmarrjes.

**Asistenca individuale:** Asistenca për organizata individuale lidhur me planifikimin strategjik, menaxhimin organizativ dhe lehtësime të proceseve të tjera, do të realizohet përkundrejt një pagese ditore prej 15.000 Lek. Në këto raste organizata përfituese është përgjegjëse për të gjitha kostot dhe arranzhimet logjistike.